

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ReNRGY Trading Group Sh.p.k.

NENI 1

Themelimi dhe emri

Sot me date 11.06.2018, nepermjet ketij akti, ne te nenshkruarit krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **ReNRGY Trading Group**, ne perputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.

Themeluesit e shoqerise jane

Z. Marsel Skendaj, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, me date 06.11.1949, mbajtes i pasaportes me nr. BD2706223, i biri i Lushes dhe i Zagollit, banues ne Adresen Rr. Dervish Hima No. 1, Ada Tower, Kati 10, Tirane, zoterues i 15% te kapitalit te shoqerise;

Z. Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 31.08.1981, mbajtes i pasaportes me nr. BI0603611, i biri i Veres dhe i Marselit, banues ne Adresen Rr. Dervish Hima No. 1, Ada Tower, Kati 10, Tirane, zoterues i 30% te kapitalit te shoqerise;

AS Venture Capital Sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me NUIS L81620019L, regjistruar prane Qendres Kombetare te Bizneseve me date 20.04.2018, me seli ne adresen Rr. Dervish Hima Nr. 1, Tirane, Shqiperi, zoteruese e 55% te kapitalit te shoqerise.

NENI 2

Objekti

Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here.

Aktiviteti i Shoqerise do te konsistoje kryesisht ne

1. Import, eksport, shitblerje, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te energjise elektrike, gazit, dhe certifikatave te gjelberta dhe gazit, brenda dhe jashte vendit.
2. Krijimi i sistemeve elektroenergjitike dhe prodhim energjise elektrike nepermjet te gjitha formave, perfshire por pa u kufizuar nepermjet sistemeve te paneleve diellore, mullinjve te eres, hidrocentraleve mbi burimet hidrike te lejuara nga organet kompetente, ndertimi i liqeneve artificiale, mbi basene ujore, me qellim prodhim dhe shitblerje energjie,



termocentraleve, nepermjet koncesionit, partneritetit publik-privat, apo ndonje forme tjeter te parashikuar nga ligji per te ushtruar kete aktivitet.

3. Ndertim, projektim, zbatim te te gjitha linjave dhe sistemeve te interkonjeksionit per percjelljen e energjise elektrike.
4. Realizimin e projekteve koncesionare dhe/ose partneritet publik-privat me institucione te pushtetit qendror dhe autoritetet vendore, ne fusha te ndryshme, per vete apo per persona te trete, perfshire ketu edhe asistencen dhe konsulencen teknike, ligjore, financiare, fiskale kundrejt shoqerive tregtare dhe/ose institucioneve publike ne kryerjen e procedurave koncesionare dhe/ose partneriteteve publike-private ne çdo sektor apo edhe kundrejt paleve te tjera financiare, tregtare, apo te tjera.
5. Ofrimin e sherbimeve te ndermjetesimit te marreveshjeve mes shoqerive tregtare (shqiptare dhe te huaja).
6. Pjesemarrje ne shoqeri, ortakeri apo shoqeri te thjeshta (konsorcium dhe joint venture) nepermjet zoterimit te kuotave/aksioneve, pjeseve te fitimit si dhe kryerja e investimeve ne shoqeri shqiptare dhe te huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqerive dhe asistenca ne veprimtarine e tyre.
7. Ne pergjithesi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transaksioni me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme qe lidhen me objektin e lartpermendur te shoqerise.
8. Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet e tjera tregtare, industriale, te luajtshme, te paluajtshme si edhe financiare (kjo e fundit gjithsesi jo ne nje forme mbizoteruese dhe jo per publikun) qe do te konsiderohen te nevojshme vetem per qellimin e arritjeve te objektit te Shoqerise si me siper, duke perfshire dhenien e dorezanive dhe garancive, perfshire ato te paluajtshme, kundrejt çdokujt per te garantuar detyrimet edhe te nje pale te trete.

NENI 3

Selia

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Dervish Hima, Nr. 1, K. 1, Tirane, , Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojë filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar.

NENI 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

NENI 5

Kapitali



5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 Leke (*njeqind mije*). Kapitali eshte i ndare ne 3 kuota qe zoterohen si me poshte:

- 1 kuote me vlere 15.000 Leke qe perfaqeson 15% te kapitalit te Shoqerise zoterohet nga Z. Marsel Skendaj, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, me date 06.11.1949, mbajtes i pasaportes me nr. BD2706223;
- 1 kuote me vlere 30.000 Leke qe perfaqeson 30% te kapitalit te Shoqerise zoterohet nga Z. Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 31.08.1981, mbajtes i pasaportes me nr. BI0603611;
- 1 kuote me vlere 55.000 Leke qe perfaqeson 55% te kapitalit te Shoqerise zoterohet nga shoqeria AS Venture Capital Sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me NUIS L81620019L, regjistruar prane Qendres Kombetare te Bizneseve me date 20.04.2018 me seli ne adresen Rr. Dervish Hima Nr. 1, Tirane, Shqiperi.

Kuotat jane nenshkruar teresisht nga Ortaket e siperpermendur dhe do te paguhen sipas kerkeses se administratorit te Shoqerise.

Pergjegjesia e Ortakeve per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 6

Administrimi i Shoqerise

6.1 Pasuria, veprimtaria dhe aktiviteti i Shoqerise do te administrohet nga nje administrator i emeruar dhe caktuar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, per nje afat 5 vjeçar nga data e ketij akti.

6.2 Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij/saj.

6.3 Administratori i shoqerise eshte Z. Marsel Skendaj, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane, me date 06.11.1949, mbajtes i pasaportes me nr. BD2706223

6.4 Administratori do te ushtroje kompetencat e tij perkatese deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:

- largimi i tij; ose
- verifikimi i ngjarjeve te percaktuara ne kete Statut te Shoqerise; ose
- perfundimi i afatit 5 vjeçar nga data e ketij akti, nese mandati nuk eshte rinovuar.

6.5 Administratori ka kompetenca te plota per te marre vendime per administrimin e zakonshem te Shoqerise, pervec kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit te zbatueshem. Administratori do te kete keto kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise sipas parashikimeve te Ligjit.

6.6 Administratori i Shoqerise mund t'i transferoje çdo personi apo grupi personash te gjithe apo nje pjese te kompetencave te tij sipas ketij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si te arsyeshme dhe ne çdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

ne çdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

NENI 7.

Pergjegjesia Personale

Pasuria e ortakëve, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve të Shoqërisë, është e perjashtuar nga çfarëdo lloj detyrimi që rëndon mbi Shoqërinë.

NENI 8

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon me themelimin e Shoqërisë dhe përfundon në datë 31 dhjetor të të njëjtit vit.


Ky akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale.

ORTAKET THEMELTAR

AS VENTURE CAPITAL SH.P.K.

Perfaqësuar nga Zj. Anisa Skendaj


GJERGJ SKENDAJ


Anisa Skendaj

Gjergj Skendaj
G

MARSEL SKENDAJ




Marsel Skendaj